



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Vitisë- Opština Vitina- Municipality Vitina



DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

Në bazë të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale neni 62, paragrafi 3 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008; Ligjit nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitat e Republikës, Ligji Nr.02/L-52 për edukimin parashkollor, si dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ nr 03/2022 për përfshirjen e fëmijëve në edukimin parashkollor në Kosovë, neni 4 paragrafi 8. Drejtoria Komunale e Arsimit në Viti shpall:

KONKURS

Për pranimin e fëmijëve në Çerdhen "Gëzimi Ynë" në Viti dhe në paralelen e ndarë

në Qifllak, për vitin shkollor 2024 – 2025

Grupmosha si në vijim:

- 9 muaj - 2 vjeç
- 2-3 vjeç
- 3-4 vjeç
- 4-5 vjeç
- 5-6 vjeç

Konkursi mbetet i hapur nga data: 26.06.2024 - 10.07.2024

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA
DREJTORIA E ARSIMIT - UPRAVA ZA OBRAZOVANJE

Pranuar - Primjeto Më/Dana: 26.06.2024

Nr i organit broj Organa	Numri-Broj	Shtojcë Prilog	Vlera Vrednost
05-	206/01		-

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e komunës së Vitisë.

Aplikacioni (Formulari i aplikimit) merret dhe dorëzohet në Çerdhen "Gëzimi Ynë" në Viti, çdo ditë pune, duke filluar nga ora: 08:30 - 15:00.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Ekstrakti i lindjes së fëmijës (origjinal, jo më i vjeter se 6 muaj);
- Letërnjoftimi i dy prindërve (kopje);
- Kontratat e dy prindërve që dëshmojnë se janë në marrëdhënie pune (kopje);
- Kartela e imunizimit të fëmijës-vakcionimit;
- Dëshmi e pagesës së trustit pensional;
- Raport për gjendjen e përgjithshme shëndetësore të fëmijut .

> Dokumentet e pa kompletuara nuk do të shqyrtohen.

Vërejtje:

Institucioni - Çerdhja "Gëzimi Ynë" në Viti, duhet të veproj konform nenit 4, të Udhëzimit Administrativ me nr.03/2022 për përfshirjen e fëmijëve në edukimin parashkollor. Duke krijuar grupet përkatëse si dhe duke përcaktuar ecurinë e përgjithshme të regjistrimit, duke respektuar kapacitetet infrastrukturore dhe profesionale të institucionit.

Të gjithë aplikuesit që janë me lokacion më të afërt me institucionin parashkollor, pranohen në lokacionin më të afërt. (afërsia zonale - 4 km).

Pas përfundimit të procedurave të konkursit, komisioni për pranimin e fëmijëve përpilon listën e të pranuarve eventual si dhe udhëzon prindërit për plotësim të dosjes së fëmijës së tyre me të dhënat shtesë të cilat dorëzohen në fillim të muajit shtator. Atëherë kur bëhet regjistrimi i fëmijëve, duhet të bashkangjiten edhe këto dokumente:

- Analizat mikrobiologjike (strishoja e hundës, fytit dhe analiza për parazit në zorrë- (jo më të vjetra se 2 javë para se të regjistrohet fëmija)

Datë: 26.06.2024

Drejtoresha

Arta Ajeti

